



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar
Tiranë, më 04.09.2019

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
KOMISIONIT EVROPIAN, PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË
BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, SHQIPËRI - KOSOVË 2014-2020,
ALOKIMET E VITIT 2017”**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 04.09.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për Programin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Shqipëri- Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Adnor Shameti.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm z. Sokol Dedja zëvendësministër i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Nëpërmjet projektligjit të propozuar synohet ratifikimi i marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2017.

Programi i bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin midis dy vendeve, nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Ky program mbështet, gjithashtu, shkëmbimin e eksperiencës dhe të njohurive ndërmjet përfituesve si dhe përmirësimin e politikave publike ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e programit. Programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme:

- Mbrojtja e mjedisit, promovimi i politikave të zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimit dhe menaxhimit të rreziqeve;
- Inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore e natyrore;
- Investimi në rini, arsim dhe aftësi;

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financiare do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen, ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, sipas prioriteteve të përcaktuara në program, duke u mundësuar, në këtë mënyrë, aktorëve rajonalë dhe vendorë, nga të dyja vendet, të shkëmbejnë jo vetëm njohuritë dhe përvojat, por edhe të prodhojnë rezultate të dukshme dhe një efekt të matshëm për sektorin social-ekonomik. Alokimet e vitit 2017 për këtë program financohen nga një grant i BE-së, nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 840 000 euro, për të dyja vendet.

Marrëveshja e paraqitur për ratifikim përbën marrëshjen e katërt të financimit për të njëjtin program të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian. Përfitues të këtij programi janë Qarku i Lezhës dhe Qarku i Kukësit.

Marrëveshja e financimit për këtë program përbëhet nga 6 pjesë:

- Kushtet e veçanta në të cilin specifikohen palët nënshkruese, afatet e zbatimit dhe specifika të tjera thelbësore;
- Shtojca I: programi i veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar (BNK) Shqipëri-Kosovë për vitet 2015-2017 që parashikon modalitetet e zbatimit të programit, përfshirë alokimet për secilin vit financiar, prioritetet e programit, kushtet e thirrjeve për projektpropozime dhe monitorimin e performancës së programit;
- Shtojca IA: Programi IPA II BNK 2014-2020 midis Shqipërisë dhe Kosovës përmban një analizë të karakteristikave kryesore të territorit të lejueshëm,

- prioriteteve dhe ofron një pasqyrë të sfidave të zhvillimit që rrethojnë zonën e programit, të cilat mund të trajtohen nëpërmjet projekteve të përbashkëta;
- Shtojca II: (Kushtet e përgjithshme), ku parashikohen, përgjegjësitë dhe strukturat zbatuese të programit;
 - Shtojca III dhe Shtojca IIIA të marrëveshjes paraqesin modelet e raportit vjetor të zbatimit për secilin program të bashkëpunimit ndërkufitar, përfshirë dhe një raport të përbashkët për të gjitha programet e bashkëpunimit ndërkufitar që përfiton vendi ynë, pavarësisht nga zbatimi nën menaxhimin indirekt apo direkt nga ana e Komisionit Evropian.

Shqipëria dhe Kosova do të bashkëpunojnë ngushtë me Delegacionin e BE-së në Tiranë për koordinimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit. Struktura institucionale e programit është e përbërë nga autoriteti kontraktues i programit, Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, Sekretariati i Përbashkët Teknik si dhe koordinatorët kombëtarë të fondeve IPA të dyja vendeve përfituese.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka marrë iniciativën për konsultimin publik të përmbajtjes së programit, duke bërë publike në faqen zyrtare të ish-Ministrit të Integrimit Evropian të gjitha dokumentet apo edhe draftdokumentet, për të cilat është gjykuar se mund të kenë interes publik. Procesi i përgatitjes dhe konsultimit të programit filloi në korrik të vitit 2013, duke vazhduar deri në maj 2014, kur edhe u dërgua drafti final për miratim nga ana e Komisionit Evropian.

Marrëveshja e financimit është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 568, datë 3.10.2018, dhe është nënshkruar për palën shqiptare në datën 23.10.2018.

Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financiare, është caktuar të jetë 12 vjet nga hyrja në fuqi e saj. Periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financiare, është 6 vjet nga hyrja e saj në fuqi.

Financimi i çdo projekti nga kjo marrëveshje (përveç projektit të asistencës teknike) është në raportin 85% grant i BE-së dhe 15% bashkëfinancim kombëtar. Projektet fituese përcaktohen pas vlerësimit të aplikimeve që dorëzohen nga aplikantët gjatë fazës së thirrjes për projektpropozime.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Anëtarët e Komisionit vlerësojnë rëndësinë e projektligjit, i cili do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen, ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, duke u mundësuar, në këtë mënyrë, përfituesve nga të dyja vendet të shkëmbejnë jo vetëm njohuritë dhe përvojat, por edhe të prodhojnë rezultate të dukshme në sektorin e mjedisit, turizmit, arsimit etj.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

ADNOR SHAMETI

ULSI MANJA